

LEKSIKU ANTROPONIMIK DHE PATRONIMIK I RAJONIT TË GOSTIVARIT

Izmit DURMISHI

Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

izmit.durmishi@unite.edu.mk

811.18'28'373.23

Abstract

This research paper aims at examining people's names (anthroponyms) together with the family names (patronymic) which have recently arisen the interest of researchers. Specifically, we will discuss the names of the young population in recent years in the city of Gostivar and its vicinity. It is evident that people's names as well as names of places have come to life with the birth of language. The same names increase in number, develop, change or go out of use depending on the historical, cultural and social circumstances that people experience.

Anthroponyms are proper nouns, as such, they derive from the common source, mainly from the common names. As an illustration, we will mention the personal name *Dritan* that derives from the word *dritë* (light) of the lexicon of general Albanian vocabulary and which has a wide use in this language realm. This is the case with the names *diell* (sun) and *yll* (star) which have derived into personal names *Diellzë* and *Yllkë*. According to the composition, anthroponyms of this region come to light as normal names (*Zanë*, *Borë*, *Besë*, *Andi*), derivative (*Besnik*, *Fisnike*, *Mallzim*, *Gentian*) and composite (*Donart*, *Valmira*, *Mirlind*) etc.

Key words: *Anthroponyms, proper names, source, general lexicon.*

Përmbledhje

Punimi ka për synim të shqyrtojë emrat e njerëzve (antroponimet), bashkë me emrat familjarë (patronimet), të cilat kanë ngjallë interesimin e studiuesve më në zë, qysh herët. Në mënyrë të veçantë do të trajtojmë emrat e të rinjve, gjatë viteve të fundit në qytetin e Gostivarit me rrethinë. Dihet se emrat e njerëzve, sikurse edhe emrat e vendeve, janë shfaqur me lindjen e gjuhës. Të njëjtit shtohen, zhvillohen, ndryshojnë apo dalin jashtë përdorimit, varësisht nga rrethanat historiko-shoqërore dhe kulturore që përjeton populli. Antroponimet janë emra të përveçëm dhe, si të tillë, kanë të përbashkët burimin e tyre kryesisht nga emra të përgjithshëm.

Sa për ilustrim po përmendim emrin vetjak *Dritan* që ka ardhur nga fjala *dritë* e leksikut të përgjithshëm të shqipes, dhe që ka përdorim të gjerë në këtë areal gjuhësor. Kështu ndodh edhe me emrat e tipit *diell* e *yll* të cilët kanë kaluar në emrat personal *Diellzë*, *Yll* e *Yllkë*. Sipas përbërjes, antroponimet e këtij rajoni na dalin si emra të parmë (Zanë, Borë, Besë, Andi), të prejardhur (Besnik, Fisnike, Mallzim, Gentian) dhe të përbërë (Donart, Valmira, Mirlind) etj.

Fjalë kyçe: *Antroponime, patronime, emra të përveçëm, burimi, leksiku i përgjithshëm.*

Hyrje

Punimi që po shqyrtojmë ka për qëllim të vë në dukje prirjen e prindërve shqiptarë për t'i pagëzuar fëmijët sot, prejardhjen e këtyre emrave vetjakë dhe mbiemrave, si dhe përbërjen e tyre. Hulumtimin e kemi bazuar në vështrimin që iu kemi bërë emrave personal në terren dhe në disa shkolla fillore të Gostivarit, edhe atë: “Ismail Qemali”, “Goce Dellçev”, “Bashkimi” në Gostivar. Çështjen e leksikut antroponimik dhe patronimik të rajonit në fjalë e vënë në dukje edhe emrat personal të nxënësve shqiptarë të klasës së I të arsimit nëntëvjeçar. Në vazhdim të punimit do të jepen të dhëna edhe për mbiemrat (patronimet) që shkojnë si zakonisht pas emrit. Për fund do të nxirren konkluzione se cila është prirja e prindërve për t'i pagëzuar fëmijët e tyre sot dhe si ka qenë dikur.

Emrat e përveçëm dhe studimi i tyre

Onomastika kryesisht përbëhet nga dy grupe të mëdha emrash: a) emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (antroponimet) dhe emrat familjarë përkatës të tyre mbiemrat (patronimet) dhe b) emrat e vendeve (toponimet), të cilat, pasi janë të shumtë mund të grupohen në disa grupe: oikonime (emra venbanimesh), hidronime (emra ujërash), oronime (emra malesh, fushash, kodrash)⁴ etj.

Emrat e njerëzve dhe mbiemrat që janë kryesisht temë shtjellimi në këtë kumtesë, janë shfaqur me lindjen e gjuhës. Ato shtohen, zhvillohen, ndryshojnë apo dalin nga përdorimi sipas rrethanave historiko-shoqërore që përjeton popullsia e çdo vendi. Për të parë kahjen e zhvillimit apo ndryshimit të emrave, qoftë në planin diakronik apo sinkronik, gjuhëtarët e interesuar për këtë çështje, qofshin ato të huaj apo vendës, në shekullin e XX e kultivuan një disiplinë të re – onomastikën.

⁴ Shpjegime për onomastikën kanë vënë në dukje edhe : Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2000, f.13; Asllan Hamiti - Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Shkup, 2014, f.273

Onomastika është mbështetësja më e fortë për të dëshmuar edhe autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre, duke provuar vijimësinë sipas ligjeve fonetike të shqipes të shumë antroponimeve dhe patronimeve shqiptare qysh nga ilirishtja e deri te shqipja e sotme, në mbarë tërthoret gjeografike ku banojnë shqiptarët. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të leksikut antroponimik dhe patronimik të zonës që po shqyrtojmë, përpos emrave të vjelë në terren, po shënojmë edhe një numër të konsiderueshëm emrash e mbiemrash të nxënësve në disa shkolla fillore, të lindur më 2008⁵, edhe atë:

Marisa Rufati, Velsa Zaimi, Edis Ismaili, Ernisa Jakupi, Dion Sadiku, Diellza Saliu, Tuana Jusufi, Arnit Zenki, Erina Fejzi, Ali Jashari, Armin Aliji, Rida Nuredini, Gëzim Bakiu, Agon Lushi, Berat Kasami, Ernand Demiri, Rron Ismaili, Blend Ismaili, Fluent Sulejmani, Edi Zendeli, Korab Imeri, Andi(5) Selimi, Afra Alirizai, Amra Xhabiri, Labina Osmani, Suela Dauti, Mevlana Latifi, Elhan Ajeti, Erina Latifi, Furkan Zendeli, Leonita Ademi, Majlinda Murtezani, Muhamed(3) Ziberi, Erzana Zejnuni, Nuhi Ajdari, Anida Bajraktari, Zana Mazllami, Afan Durmishi, Alena Jakupi, Vlera Kadriu, Amra Limani, Deon Nuredini, Flondrit Xhelili. Elsa(2) Hasa, Besar Demiri, Fatime Ramadani, Lisa Beta, Eliza Arifi, Anisa Tusha, Shpresa Ameti, Eda (2) Selimi, Alea Zulfiquari, Amin Bajrami, Armira Tairi, Lina Shaqiri, Enxhi Memedi, Gafar Neziri, Rexhije Asani, Aldin Emini, Amir Emini, Erina Emro, Donart(2) Idrizi, Mert Jusufi, Esra Zuferi, Ajan Osmani, Sara(6) Nuredini, Lorand Abazi, Amra Bekteshi, Erion Selimi, Jara Kreci, Ibrahim Bexheti, Jasin(2) Rustemi, Arbi Iseni, Hasan Hasani, Dorart Jonuzi, Altina Ramadani, Aulona Alili, Amina Useini, Drita Saliu, Dilara Aliji, Tuana Qamili, Zejnep Mustafi, Shqipe Osmani, Kushtrim(2) Hasani, Erin Sulejmani, Melisa Ademi, Berat Shaini, Aksa Veseli, Fatjona Ameti, Amina Aliu, Festim Aqifi, Aldin Beqiri, Alma Iseini, Laura Musliu, Melisa Iseini, Semra, Ismaili, Erian Limani, Rejhan Rexhepi, Sunaj Merseli, Ajla Ramadani, Valmira Saiti, Mirsad Nuredini, Rinor Zeqiri, Fetije Neziri, Fatime Muharemi, Medina(2) Mustafi, Abdilalim Musliu, Semra Musliu, Adisa Adili, Armin Nesimi, Arianit Ismaili, Besfort(2) Abdul, Erdi Sejdini, Samina Adili, Valton(2)⁶ Iljazi, Suela Ademi, Eliza Aqifi, Besa Aliu, Veton Ameti, Elsana Saliu, Hafsa Bilalli, Hava Ejupi, Musa Fetai, Jasmin Saliu, Gent Fetai, Valon(2) Ejupi, Saranda Abazi, Artan Hamiti, Aida Demiri, Besfort Fetai, Meriton Hamzai, Luiza Aliu, Miron Xhelili, Triumf Memedi, Shkëlqim Alili, Fatime Ameti, Arta Jusufi, Adelina Bajrami, Anisa Alija, Arbi(3) Bilalli, Bora(3) Elmazi, Bardh Dalipi, Erza Xhaferi, Elion Aligega, Elda Alia, Dijon Ibrahim, Dijar Goxha, Hana(2) Sadiku, Lorik Ristemi, Gëzime Shahini, Lorent Toska, Gresa(3) Azizi,

⁵ Shënimet që pasojnë janë nxjerrë nga listat e regjistrimit të nxënësve në shkollat e sipërpërmendura.

⁶ Në kllapa janë shënuar emrat që kanë përdorim më të dendur në këtë zonë.

Arbër Demiri, Ardian(2) Tahiri, Besar Abdul, Blendi Selmani, Dardan Abazi, Dritan Tahiri, Eldina Rushiti, Edi Mehmedi, Eda Adili, Fisnike Akiu, Teuta Aliu, Kaltrina Selmani, Arbion Neziri, Arban Sulejmani, Altina Hasani, Bora Xhelili, Dea Abdullai, Blendi Shabani, Erina Memedi, Emira Bexheti, Leart Kadriu, Blendion Toska, Blendiona Toska, Kanita Jakupi, Agon(3) Mustafi, Endrit Mustafi, Gresa Sulejmani, Gentian(2) Ibishi, Yllzim Bajrami, Mallzime Uka, Mallzim Uka, Semira Qazimi⁷ etj.

Emrat e leksikut burimor vendës dhe atij të huaj

Sa i takon prejardhjes së emrave të sipërshënuar, mund të konstatojmë se, shumë emra të këtij areali gjuhësor janë: a) të burimit vendës (iliro - shqiptarë); b) të burimit të huaj, kryesisht emra njerëzish me prejardhje orientale (arabe-turko-persiane); c) të burimeve të ndryshme, tashti së fundmi, emra me prejardhje nga italishtja, gjermanishtja, anglishtja⁸ etj.

Si emra të vjetër me prejardhje nga ilirishtja që i takojmë të përdoren dendur në këto anë, po përmendim: *Korab, Deon, Gent, Arianit, Saranda, Bardh, Aulona, Teuta, Arta, Arbi, Arbër, Arban, Arbion, Ardian, Dardan* etj. Emrat e tillë janë dëshmi bazike që flasin bindshëm për prejardhjen e shqipes nga ilirishtja. Pra, siç vërehet, edhe në mendësinë e prindërve të kësaj ane, si në mbarë viset shqiptare, dëshira për t'i pagëzuar fëmijët e tyre me emra të bukur të gjuhës shqipe që i ka pasur më herët ilirishtja, nuk ka shkuar në harresë.

Dihet se me krijimin e kombeve edhe gjuhët morën hov zhvillimi. Kjo ndodhi në periudhën e vonshme të Mesjetës. Zhvillim të dukshëm arrin edhe shqipja sidomos në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Nga ajo periudhë, kryesisht në dekadat e fundit të shekullit XX, mori hov edhe përdorimi më i dendur i emrave kombëtarë shqiptarë⁹ me të cilët po pagëzohen sot të rinjtë e këtij rajoni në masë të konsiderueshme. Motivet e prindërve për emërtime të tilla kanë qenë të ndryshme. Pasi shqiptarët shekuj me radhë kanë vazhduar të luftojnë për lirinë e tyre, sigurisht që është dashur t'i pagëzojnë fëmijët e tyre me emra që ngërthejnë në vete ndjenjën e trimërisë, lirisë, dashurisë, fisnikërisë, bujarisë, shpresës etj.

Rritja e kontakteve dhe e bashkëpunimit midis shqiptarëve të Shqipërisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë, sidomos e këtyre të fundit, ndikoi dukshëm edhe në emërvënien të tilla. Prandaj, disa nga emrat vetjakë të këtij rajoni, po përdoren shpesh edhe në Kosovë. Si

⁷ Emrat e sipërshënuar i kemi grumbulluar kryesisht nga tri shkolla fillore: "Ismail Qemali", "Goce Dellçev", "Bashkimi". Të njëjtit i kemi shënuar bashk me mbiemrat dhe, siç mund të vërehet, shumica e mbiemrave është me prejardhje arabo-turke.

⁸ Shih: Asllan Hamiti, *Antroponimet e shqiptarëve të Maqedonisë*, Seminari i I Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2007, f.339-346

⁹ Para tri dekadash ishte e vështirë t'i pagëzosh fëmijët e posalindur me emra kombëtarë shqiptarë edhe në Maqedoni.

emra karakteristik që kanë zënë rrënjë të thella ndër banorët e këtushëm, po përmendim: *Triumf, Kushtrim, Fisnike, Shkëlqim, Erzana, Bora, Majlindë, Bukurie, Besar, Zanë, Shpresë, Dorart, Agim, Emira, Besnik, Kaltrina, Leart, Drita, Rinor, Shqipe, Gëzime, Vlera, Artan, Festim, Valmira, Lirie, Valton, Fatjona, Veton, Valon, Mirind, Agon, Yllzim, Lirim, Shpresim, Fitore, Lindita*¹⁰ etj.

Emrat vetjakë të burimit të huaj lidhen kryesisht me elementin fetar. Ato janë pjesë e një tradite të hershme fetare në këto anë dhe janë me origjinë arabo-turke. Prandaj, pasi pjesa dërmuese e banorëve të këtushëm shqiptarë është e përkatësisë fetare myslimane, s'do mend se edhe disa emra personal të kësaj natyre, kanë një shtrirje të konsiderueshme përdorimi në rrethinën e Gostivarit. Sa për ilustrim po përmendim: *Amra, Afan, Esra, Amin, Sara, Ibrahim, Jasin, Hasan, Zejnep, Aksa, Semra, Ajla, Sunaj,, Medina, Fatime, Fetie, Hava, Suela, Jasmin, Musa, Hafsa, Gafar, Afra, Nuhi* etj.

Emra të tjerë të burimit të huaj me të cilët pagëzohen sidomos të rinjtë e kësaj ane sot, janë ata që kanë depërtuar sidomos nga italishtja, anglishtja dhe gjermanishtja dhe llogariten si emra me karakter ndërkombëtarë, edhe atë: *Leonita, Denis, Laurë, Leontinë, Marisa, Edi, Elion, Elda, Lorand, Tuana, Andi, Armin, Alena* etj. Prindërit që i pagëzojnë fëmijët e tyre me këto emra, ose janë të motivuar për t'i nderuar të huajt, ose kujtojnë se po e "modernizojnë shqipen". Në fakt, emrat e tillë ia zënë frymën gjuhës sonë të bukur. Ka shqipja mjaft emra të brumit të saj, kuptimi leksikor i të cilëve përkon me veçoritë apo tiparet e këtij populli të lashtë, bujar e fisnik. Le t'i pagëzojmë fëmijët tanë me emra të tillë të bukur. Larg emrave të burimit të huaj dhe larg atyre emrave të cilëve shpeshherë nuk ua dimë kuptimin.

Format e shkurtra të emrave (nofkat)

Siç dihet, emrat e njerëzve në shqipen sikurse edhe në gjuhë të tjera, krahas formës së parë dhe të njohur zyrtare, mund të kenë edhe një formë të dytë të shkurtuar. Ka raste kur, forma e dytë e shkurtuar e emrit njihet më shumë sesa forma e plotë zyrtare. Trajtën e dytë të shkurtuar mund ta përdorim kur u drejtohem njerëzve të rrethit të ngushtë familjar, miqësor a shoqëror.

Pra, në shenjë përkëdhelie prindërit mund të përdorin në biseda të zakonshme me fëmijët e tyre trajtat me prapashtesën zvogëluese përkëdhelëse –ush: *babush, mamush, zemrush*; ose të rriturit në raporte të ndryshme shoqërore mund të përdorin prapashtesat përkëdhelëse –çe: *nipçe;-ko: dajko* etj. Në thesarin leksikor të shqipes bëjnë pjesë edhe

¹⁰ Shih: Begzat Baliu, *Onomastikë dhe identitet*, Prishtinë, 2012, f.54.

nofkat. Ato janë emërtime popullore shitesë (emër i dytë) krahas emrit zyrtar që u vihen njerëzve për tallje, për shaka etj., duke u nisur nga ndonjë e metë që mund ta ketë dikush. Ka edhe nga ato nofka që nuk kanë lidhje as me emrin e parë, as me ndonjë tipar apo të metë që mund ta kenë njerëzit. P.sh.: një djali që e ka emrin Bashkim, shokët i kanë ngjitur nofkën *Msusi*, sepse ai e ka zakon të thotë shpesh “unë jam msus për ju”.

Një djali tjetër me emrin Mexhit, shokët i thërrasin “*Stili*”, sepse ai përmend shpeshherë “unë kam stil”. Nofkat si emra të dytë u shtohen njerëzve sidomos në moshën e rinisë, më shumë për tallje, humor a nënçmim. Ato shkojnë në harresë me kalimin e moshës së rinisë. Të shumtën e rasteve nofkat burojnë nga një krahasim i ndonjë tipari të njeriut, si p.sh., *Bufi* – *Bufe* i thuajnë një djali apo vajze që ka qenë e shëndoshë që në vegjëli. *Çokar* i thërrasin një djali apo buri që është i shëndoshë dhe e ka zërin e trashë (Çegran-Gostivar).

Disa nofka lidhen edhe me motivet profesionale apo jetën e njerëzve, si p.sh., *Haxhi Pishmani* thirrej një njeri që kishte mbetur pa e ble arën që kishte planifikuar, pasi të njëjtën ia kishte blerë dikush tjetër; një studenti që studion për mjekësi, shokët ia kanë vënë emrin *Doktor* etj. Disa nofka të tjera që lidhen me profesione njerëzish, kanë kaluar në emra familjesh (mbiemra). Si të tilla dhe që kanë përdorim të gjerë në arealin gjuhësor të kësaj ane, sikurse edhe në vise të tjera shqiptare, po përmendim: Topçiu, Sahatçiu, Kafexhiu, Haxhiu¹¹.

Gjatë vjeljes së leksikut antroponimik dhe patronimik të rajonit të Gostivarit, por edhe më gjerë ndër shqiptarët e Maqedonisë, na ka rënë në sy edhe një thyerje e normës së drejtshkrimit tek emrat dhe mbiemrat e këtij areali gjuhësor. Në këtë thyerje rregullash drejtshkrimore e drejtshqiptimore që vërejmë tek emrat dhe mbiemrat, përpos faktorëve gjuhësorë kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë jashtëgjuhësor, si përkatësia fetare, administrimi në gjuhë të huaja, përpjekja për shkombëtarizim¹² etj.

Shmangie nga norma e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit të emrave dhe mbiemrave të zonës në shqyrtim së pari vërejmë në lëmin e fonetikës, edhe atë: a) rënie tingujsh te disa emra dhe mbiemra, qoftë në fillim, mes apo fund të emrit apo mbiemrit, si: *Brahim* < Ibrahim, *Gim* < Agim, *Alit* < Halit, *Amet* < Ahmet, *Du:ll* < Abdullah, Sadulla, *Sa:l* < Sali-u etj., b) zh buzorëzimi i /y/ në /i/ që është dukuri e të folmeve të gegërishtes qendrore, si tek emrat: *Imer* < Ymer, *Ill* < Yll, *Zimer* < Zymer.

¹¹ Shih: Asllan Hamiti, *Antroponimet e shqiptarëve të Maqedonisë*, Seminari i I Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2007, f. 334

¹² Po, ai, po aty, f.345

Profesor Asllan Hamiti¹³ ka vënë në dukje se ky zhbuzorëzim përkon edhe me mungesën e /y/-së në maqedonishte, si gjuhë e vetme e administratës shtetërore. Sigurisht që mungesa e disa fonemave në maqedonishten si gjuhë zyrtare, krahas shqipes, ka çuar drejt thyerjes së rregullave drejtshkrimore të emrave të shqipes, pasi emrat personal në evidencën shtetërore janë shkruar me alfabetin qirilik. Kështu bie fjala, fonemat /ë/, /th/ e /dh/ janë këmbyer me fonemat /e/, /t/, /d/: *Gzim/Gezim* < Gëzim, *Taç* < Thaç, *Bard* < Bardh etj.

Thyerje të normës për drejtshkrimin e shqipes paraqet edhe shtimi i disa mbaresave sllave, si: –*ov*, –*ovski*, – *iq*, – *viqetj*. të cilat u ishin shtuar mbiemrave të shqiptarëve të kësaj ane, po edhe më gjerë, kryesisht Pas Luftës së Dytë Botërore në ish Jugosllavi. Kështu, mbiemri Hasani shënohej *Hasanov*, Sadini shënohej *Sadinov*, Mehmeti shënohej *Memedovski*, Aliu- *Aliovski*, Kurtishi - *Kurtisheviq*. Për fat të keq edhe sot e kësaj dite në disa venbanime të Maqedonisë Lindore të banuara me shqiptarë (Veles me rrethinë), vazhdon një dukuri e tillë. Në zyrat e gjendes civile atje, ende i gjejmë të shkruar mbiemrat *Sadikovski* për Sadiku, *Durmishov* për Durmishi, *Aliovski* për Aliu etj.

Mbiemrat e shqipes me prejardhje arabo-turke

Po të vërejmë me kujdes mbiemrat (patronimet) në listën e sipërshtënuar, do të konstatojmë me sa vijon: a) pjesa më e madhe e tyre (me ndonjë përjashtim) janë të brumit të huaj turko-arabë; b) ato tani përdoren në trajtën e shquar të emërores dhe formohen nga emra personalë të të parëve të familjes, duke u shtuar mbaresa shquese të ndryshme, si: –*i*, –*u*, –*a*, –*o*. P.sh.: Marisa *Rufati*, Agon *Lushi*, Berat *Kasami*, Arbër *Demiri*, Dritan *Tahiri*, Arban *Sulejmani*, Meriton *Hamzai*, Fetije *Neziri*, Eliza *Aqifi*, Veton *Ameti*, Bora *Xhelili*, Besar *Ademi*, Flondrit *Xhelili*, Altina *Ramadani*; Vlera *Kadriu*, Fisnike *Akiu*, Deon *Sadiku*, Shpresa *Saliu*, Luiza *Aliu*, Jasmin *Saliu*; Lorent *Toska*, Blendion *Toska*, Blendiona *Toska*, Mallzim *Uka*, Dijar *Goxha*; Erina *Emro* etj., c) dikur patronimet përdorehin në rasën gjinore, si p.sh.: Veton *i Ametit*, Besniku *i Halitit*, Shabani *i Zaimit*, Shpëtimi *i Reshatit* etj.

Rreth strukturës së emrave vetjakë të leksikut të përgjithshëm

E shohim të arsyeshme të theksojmë se, një numër më i kufizuar antroponimesh janë sajuar nga leksiku i përgjithshëm i shqipes, pa pësuar ndonjë ndryshim leksiko-gramatikor,

¹³ Po ai, po aty.

edhe atë: leksema *shpresë* ka kaluar në emrin vetjak *Shpresë*, leksema *besë* ka ndihmuar të krijohet emri vetjak *Besë*, fjala *vlerë* ka dhënë emrin personal të gjinisë femërore *Vlerë-a*, leksema *agim* ka kaluar në emrin vetjak *Agim*, ndërkaq nga leksema *dritë* është krijuar emri vetjak i gj.f. *Dritë-a*; nga këtu edhe emrat e prejardhur me prapashtesa fjalëformuese të gj.m. *Dritan, Driton*.

Një numër tjetër antroponimesh janë formuar edhe duke e ndryshuar gjininë, si p.sh.: leksema *gëzim* e leksikut përgjithshëm fillimisht ka dhënë emrin personal të gjinisë mashkullore *Gëzim*, i cili, me ndryshim prapashtesash ka derivuar emrin *Gëzime* të gjinisë femërore. Një numër i vogël i antroponimeve të kësaj zone janë formuar me anë të kompozimit. Me bashkimin e leksemave *dor(ë)* dhe *art*, *maj* dhe *lind*, *bes(ë)* dhe *fort*, *fat* dhe *mirë*, janë sajuar emrat vetjakë *Dorart, Majlindë, Besfort, Fatmir* etj.

Zhvillimin e leksikut antroponimik të një zone të caktuar, si edhe atë të mbarë shqipes, e karakterizojnë një sërë faktorësh brendagjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Rrethanat e ndryshme shoqëro-politike, ekonomike dhe kulturore, kanë ndikuar në krijimin e një mendësie të veçantë të emërvënies ndër shqiptarë. Pavarësisht se ekzistojnë dallime në mentalitetin lokal, krahinor apo kombëtar të emërvënies ndër shqiptarët e zonave të ndryshme gjeografike, qofshin ato në Shqipëri, Kosovë apo Maqedoni, prapëseprapë brumi i leksikut antroponimik shqiptar nuk dallon shumë.

Nga këtu, mund të nxjerrim një fond të përbashkët të leksikut antroponimik në tërthoret gjeografike shqiptare të Maqedonisë, dhe një tjetër¹⁴ që është karakteristik për vendbanime të caktuara, qofshin ato rurale apo urbane. Nga vështrimi që u kemi bërë emrave të grumbulluar në terren dhe në listat e nxjerra të shkollave të përmendura, kemi dalluar leksema të leksikut të përgjithshëm antroponimik të shqipes që, përpos që përdoren ndër shqiptarët e Gostivarit me rrethinë, përdoren madje edhe nga mbarë shqiptarët në Maqedoni¹⁵. Si të tilla po përmendim: *fat, agim, besë, gëzim, dritë* etj., nga të cilat u krijuan emrat vetjakë më të përdorshëm të gjinisë mashkullore, si: *Fatmir, Agim, Besfort, Besnik, Besar e Besart, Gëzim, Dritan e Driton, Flondrit* etj., si dhe leksemat në vazhdim: *lule e lulëzim, gëzim, shpresë, meritë, fat, mirë, lind*, nga të cilat u krijuan emrat vetjakë më të përdorshëm të gjinisë femërore, si: *Luljeta, Lulzime, Gëzime, Shpresa, Merita, Fatjona, Fatmire, Mirjeta, Lindita* etj. Ndërkaq, si emërtime pakashumë karakteristike të kësaj zone dhe që kanë një përdorim të

¹⁴ Emrat e këtij fondi kanë përdorim më të kufizuar, ato mund të përdoren në vendbanime apo zona të caktuara.

¹⁵ Për leksikon antroponimik dhe patronimik në Maqedoni, shih edhe: Zarije Nuredini, *Ndërtimi dhe llojet e antroponimeve shqiptare në Tetovë e rrethinë*, Albanologjia, Tetovë, vol.3, No 5-6/2016, f. 83; Hidajete Azizi, *Leksiku antroponimik në arealin e Maqedonisë*, po aty, f.69.